

**Valter MEMISHA**

**FJALORI ETIMOLOGJIK ËSHTË NJË KONTRIBUT PËR HISTORINË E  
GJUHËS, LEKSIKOGRAFINË SHQIPTARE, BALLKANISTIKËN DHE  
STUDIMET INDOEUROPIANE**

UDC 811.18'374.2(049.3)

Jam i nderuar që sot në Universitetin tuaj, po çel seancën paraqitëse për veprën *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, hartuar nga akademik Kolec Topalli.

Ka dy veçanti në këtë paraqitje: ajo është e para jashtë kufijve të Shqipërisë Politike dhe për këtë, në emër të institucionit që unë drejtoj, falënderoj gjithë organizatorët e veprimtarisë, veçanërisht autoritetin drejtues të Universitetit dhe atë të Seminarit. Një falënderim i veçantë vjen edhe për z. Berton Sulejmani, me të cilin e nisëm dhe po e përfundojmë me sukses këtë sipërmarrje.

Së dyti, vepra po paraqitet pas largimit nga jetë të vetë akademikut të nderuar dhe kjo bëhet shprehëse e vlerësimit të gjithë produktit shkencor që akademiku na la trashëgim.

Kolec Topalli është marrë kryesisht me probleme të fonetikës e gramatikës historike dhe të etimologjisë së shqipes. Formimi i lartë shkencor, skrupuloziteti i skajshëm, sistematika e pazakontë në punën kërkimore e studimore, metodologjia shkencore e saktë, zotërimi i disa gjuhëve të huaja të gjalla e të vdekura janë kurorëzuar me më shumë se 250 tituj me rreth 10.000 faqe, me vepra përgjithësuese, monografi, fjalor, artikuj, referate e kumtesa.

Ai identifikohet si bashkëpunëtor i mbi 30 revistave shkencore brenda e jashtë vendit, me botime në 5 gjuhë të huaja, si pjesëmarrës me referate e kumtesa në 120 konferenca shkencore kombëtare e në 58 ndërkombëtare, duke dhënë ndihmesë të pazëvendësueshme në studimet albanologjike, në vazhdimësinë e punës së studiuesve më të shquar të shqipes dhe në ngritjen e prestigjit të shkencës sonë bashkëkohore në arenën ndërkombëtare.

Kolec Topalli ishte anëtar i komisionit të Atlasit të gjuhëve Evropiane, ALE (Atlas Linguarium Europae), në vitin 2008 zgjidhet anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe më 2012 anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Senati Akademik i Qendrës së Studimeve Albanologjike i ka dhënë titullin “Profesor Nderi i Studimeve Shqiptare”, kurse Presidenti i Republikës e ka nderuar me urdhrin “Mjeshtër i Madh”.

Vepra që na la trashëgim akademiku është e madhe në vëllim dhe në vlera. Si autor i 15 veprave madhore, ai u bë provë e suksesit të shkollës albanologjike shqiptare. Në fushën e fonetikës historike ka botuar: “Theksi në gjuhën shqipe” (1995); “Për historinë e hundorësisë së zanoreve në gjuhën shqipe” (1996); “Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes” (1998); “Shndërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe” (2000); “Sonantet e gjuhës shqipe” (2001); “Mbylltoret e gjuhës shqipe” (2002); “Fërkimoret e afrikatet e gjuhës shqipe” (2003); “Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe” (2004); “Fonetika historike e gjuhës shqipe” (2005) (nderuar me çmimet “Ekselencia Shqiptare 2007” dhe “Çmimi i Albanologjisë 2008”); “Kërkime mbi historinë e theksit në shqipe”, Kozencë, 2007.

Kurse në fushën e gramatikës historike ka botuar monografitë: “Evolucioni historik i përemrave të shqipes” (2008); “Nyjat e shqipes” (2009), Sistemi rasor i emrave të shqipes” (2009); “Sistemi foljor i gjuhës shqipe” (2010); “Gramatikë historike e gjuhës shqipe” (2011, nderuar me çmimin e revistës “Kult” 2012”, si vepra shkencore më e mirë e vitit).

Në fund të vitit 2017 akademiku botoi Fjalorin Etimologjik të Gjuhës shqipe, fitues i Çmimit “Çabej”, si vepra më e mirë shkencore e vitit 2017 në fushën e studimeve albanologjike. Fjalori sendërtonte një punë mbi 50-vjeçare dhe qëndron në ballë të prurjeve shkencore të albanologjisë së këtij shekulli. Ai bëhet tregues i punës pa orar, i përkushtimit, i sakrificave, i përballimit intelektual të vështirësive të panumërta që i dolën autorit gjatë hartimit. Me këtë vepër akademiku na tregoi si punohet dhe sesi duhet të vazhdojmë më tej.

Puna për hartimin real të *Fjalorit etimologjik*, merr udhë në fillim të vitit 2011 dhe mbyllet në mesin e vitit 2016, duke u sendërtuar në një vepër me 1984 faqe. Ai fillimisht u mendua disavëllimësh, madje kështu është diskutuar dhe në Dapartamentin e gramatikës dhe të historisë së gjuhës, pranë IGJL-së. Autori me të drejtë propozoi formatin njëvëllimësh që, tashmë, e kemi në duar.

“*Fjalori etimologjik* është një kontribut jo vetëm për historinë e gjuhës e leksikografisë shqiptare, por edhe për ballkanistikën dhe studimet indoeuropiane. Para këtij fjalori janë botuar kryesisht studime etimologjike, më së pari prej të huajve e më vonë edhe prej shqiptarëve e arbëreshëve, studime që arrijnë pikën më të lartë me hulumtimet etimologjike në fushë të shqipes prej patriarkut të shqipes, akademik Eqrem Çabej. Krahas studimeve të mirëfillta për këtë fushë, janë botuar edhe dy fjalorë etimologjikë, njëri gjermanisht prej Gustav Meyerit para gati një shekulli e gjysmë e tjetri anglisht prej Vladimir Orelit në fund të shekullit të kaluar. Por këta fjalorë mbartin mangësi që lidhen me kohën kur u hartuan, me me njohjen e shqipes si dhe me nivelin e studimeve për këtë gjuhë. Fjalori i K. Topallit vjen të plotësojë një nevojë të ndjeshme në fushë të etimologjisë duke pasuruar më tej fondin e leksikografisë shqiptare dhe të studimit historik të gjuhës shqipe.

Për hartimin e kësaj vepre akademik Kolec Topalli është mbështetur në studimet etimologjike dhe ato në fushën e historisë së shqipes që janë të shumta dhe janë bërë nga figura të shquara, albanologë shqiptarë dhe të huaj të kalibrit botërorë, evropianë e ballkanikë. Punimet e tyre janë parë me themel nga Kolec Topalli dhe nëse sheh bibliografinë e Fjalorit, aty do të gjejmë mbi 1000 autorë dhe vepra, 297 burime si fjalorë etj.

Por pikë kryesore referimi për hartimin e Fjalorit janë studimet e E. Çabejt, të cilat, sipas fjalëve të hartuesit të veprës i “kanë shërbyer si pikëmbërritje dhe si pikënisje; si pikëmbërritje, meqenëse në hulumtimet e tij janë përmbledhur të gjitha studimet e mëparshme bashkë me kritikën përkatëse; si pikënisje, meqenëse plotësimet, shtesat e zgjidhjet e reja i kemi bërë duke u nisur nga ky dijetar, ashtu sikurse ai vetë në kohë të tij mori si pikë referimi studimet etimologjike të Meyerit.” Çabej shkencërisht pjesën dërmuese të këtyre fjalëve të pashpjegueshme ia ktheu burimit shqip. Në këtë rrugë ecën edhe K. Topalli, ndaj në fjalorin e tij gjenden njësi me zgjidhje etimologjike shkencore të njohura e të mirëpranura, gjenden njësi me zgjidhje të reja etimologjike, si dhe njësi të shenjuara me burim të errët a të paditur, duke lënë të hapur hulumtimin e zgjidhjet shkencore për të ardhmen.

Fjalori etimologjik, përmes etimonit të fjalëve, synon t’i japë shqipes ç’i takon shqipes, të tregojë se ç’ka trashëguar nga nëna e vet dhe ç’ka krijuar në rrjedhë të shekujve, të tregojë lashtësinë e shqipes e të shqiptarëve, autoktonë në këto troje, indoevropianësinë e rrugën historike të gjuhës sonë, të tregojë rrugën e mbijetesës e saj në rrjedhat e kohës. Vepra sendërtonte thënien lapidare të prof. Çabejt se historia e një gjuhe është historia e popullit që e flet atë.

Fjalori sendërton studime dhe punë hartuese që e bëjnë atë vepër që vlen për të sotmen e për të ardhmen. Për të sotmen, sepse ai është një përmbledhje e rezultateve të arritura në këtë fushë nga gjuhëtarë të të gjitha periudhave nga vende të ndryshme. Për të ardhmen, sepse fjalori shërben si një bazë prej nga nisin hulumtimet e reja. Kjo fushë, ndër më të vështirat e historisë së gjuhës, do të vijojë të zhvillohet e të pasurohet me hulumtime të tjera nga studiues të tjerë sot por dhe nga brezat pasardhës, të cilët rezultatet e arritura deri në ditët e sotme, do t'i çojnë ato më tej me përmirësimin e metodës së kërkimeve shkencore, me materialet gjuhësore që do të dalin në dritë dhe me teknikat e reja që do të aplikohen edhe në studimet e kësaj fushe.

*Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe* nuk vjen për të qëndruar në bibliotekat akademike apo në tavolinat e shkencëtarëve. Duke rimarrë fjalët e prof. Kolec Topallit, ai vjen për t'u përdorur, sepse "u duhet në radhë të parë albanologëve që merren me studimin e shqipes, indoevropianistëve, ballkanologëve, helenistëve, romanistëve e sllavistëve; u nevojitet dijetarëve të shkencave të tjera jogjuhësore, ashtu si u shërben edhe intelektualëve të tjerë të çfarëdo fushe e deri studentëve e nxënësve të shkollave, që kanë dëshirë të njohin origjinën e fjalës shqipe. Fjalori u drejtohet jo vetëm shkencëtarëve e dijetarëve të gjuhës, por edhe mësuesve, studentëve e profesionistëve të ndryshëm, që kanë dëshirë të njohin burimet dhe historinë e fjalëve të shqipes. Ai u drejtohet edhe shtresave të gjera, madje edhe pa një arsim universitar të mirëfilltë." Vepra shkon kështu në dorë të çdo shqiptari, që jeton në mjediset shqipfolëse, por edhe në diasporë e emigracion.

Më gjerë për vlerat dhe rëndësinë e veprës do të flasin kolegët e tjerë, nga Tirana, Prishtina e Tetova  
Faleminderit!